



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:239817

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05488589

C.nr.1021/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC - Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Berkan Hamza, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses D.D, nga Rahoveci, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Av. D.M, nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson B.O, avokat në Rahovec, me objekt kontesti kompensimi nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1,383.75 euro, jashtë seance me datë 22.03.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.D, nga Rahoveci.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses D.D, në emër të kompensimit për licencim, për periudhën kohore nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.01.2023, për 27% të pagës bazë (421.00 euro) x 27% (minusuar 58.32 euro në listën e pagave nga shuma 113.67 euro) = 55.35 euro x 25 muaj, t’ia paguaj shumën prej 1,383.75 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8% nga data 06.11.2023 (data e parashtrimit të padisë) e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes të këtij aktgjykimi, me pasojat ligjore të përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Rahovecit - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses t’i paguajë shumën prej 125.00 në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja D.D në këtë gjykatë me datë 06.11.2023, përmes të autorizuarit të saj kanë ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Rahovecit– Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin nga marrëdhënia e punës vlera e kontestit 1,383.75 euro.

E njëjta sipas padisë ka theksuar se ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në ShFMU “Isa Boletini” në Rahovec, ku ka punuar nga data 01.01.2021 deri 31.01.2023, ndërsa nuk është llogaritur në page dhe nuk është paguar diferenca në pagë sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës të datës 29.08.2008, e nuk është paguar deri më tash.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale e Arsimit, përmes të autorizuarit së saj B.O, në këtë gjykatë ka paraqitur përgjigje në padi me datë 09.02.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar, ndërsa e drejta për kompensim mbi bazën në të cilën janë thirrur pala paditëse nuk ka bazë të qëndrueshme ligjore. Andaj, e konteston kërkesëpadinë e paditëses pasi që i mungon legjitimiteti real-pasiv për të qenë palë në këtë çështje kontestimore. Duke shtuar se kërkesa në kuptim të nenit 87 të Ligjit të Punës, është parashkruar. Andaj i ka propozuar gjykatës që kërkesëpadinë e paditësit ta refuzoj tërësisht si të pa bazuar ndaj të paditurës Komuna Rahovecit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 dhe 398 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko-civile duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që:

Nuk ishte kontestues fakti se paditësja kishte të themeluar marrëdhënien e punës me kontratë tek e paditura. Në këtë çështje juridike kontestues mbetet fakti se a i takon paditëses kompensimi në bazë të kualifikimit dhe a është kërkesa e parashkruar.

Kështu, gjykata ka vendosur ta aprovojë kërkesëpadinë e paditëses në pjesën e kualifikimit për shkak se në bazë të Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, në pikën 1. të këtij vendimi përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Pra, nga përmbajtja e vendimit nr.01/33 të datës 29.08.2008 dhe me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet dhe kriteret sipas mënyrave të përcaktuara të licencimit dhe se në bazë të këtyre kriterëve mësimdhënësve u takon kompensimi nga marrëdhënia e punës. Në këtë rast paditëses D.D në bazë të shkallës së licencimit, për shkak se posedon diplomë të nivelit Bachelor i ka takuar kompensimi nga paga bazë prej 27%.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses t'i paguajë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës rezulton se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, paditëses ia ka paguar shumë prej 58.32 euro. Andaj, gjykata vendosi si në pikën nën II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke e detyruar të paditurën

që paditëses nga data 01.01.2021, e deri me datën 31.01.2023 për 27% të pagës bazë t'i paguaj shumën prej 55.35 euro për 25 muaj e gjithsej shumën e përgjithshme prej 1,383.75 euro.

Në këtë drejtim, gjykata po ashtu ka analizuar edhe rregullativën nënligjore, gjegjësisht Udhëzimin Administrativ Nr.5/2017 për Sistemin e Licencimit dhe Zhvillimit të Mësimdhënësve në Karrierë (tutje: UA) i datës 18.04.2017, në të cilin, në nenin 24 parashihen Detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë Komunale për Arsim, ku paragrafi 3 i këtij neni parasheh *“Siguron buxhetin për ZHP të gjithë mësimdhënësve në nivel komune”* dhe paragrafi 4 *“Zbaton Sistemin e financimit të gradimit të mësimdhënësve të lidhur me këtë UA”*. Pra në bazë të këtyre dispozitave e paditura obligohet që të sigurojë buxhet të mjaftueshëm si dhe të zbatojë sistemin e financimit lidhur me licencimin e mësimdhënësve.

Sa i përket çështjes së parashkrimit, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me parashkrim të kërkesës për faktin se padia e paditëses është dorëzuar më datën 06.11.2023, ndërsa kërkesëpadija e paditëses përfshin periudhën kohore prej datës 01.01.2021, e deri me datën 31.01.2023. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate baza juridike e parashkrimit të kërkesave në të holla në kontestet e marrëdhënies së punës është në nenin 87 të Ligjit të Punës, sipas të cilit *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*. Prandaj edhe kërkesa është brenda afatit 3 vjeçar.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se *“Kur gjykata, pasi t'i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*.

Nga të lartcekurat, duke u mbështetur në dispozitat e nenit 87 të Ligjit të Punës, Udhëzimit Administrativ Nr.5/2017, Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, nenit 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, nenit 329 dhe nenit 398 të LPK-së gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së, i cili përcakton se: *“Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t'ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve”*, në kuptim të kompensimit të shpenzimeve të palës gjyqësore, duke vendosur që paditësja t'ia kompensojë të paditurit shumën si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, në shumën e përgjithshme prej 125.00 euro, dhe atë për përpilimin e padisë 104.00 euro si dhe për taksën gjyqësore 21.00 euro.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC  
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil  
C.nr. 1021/2023, më datën 22.03.2024

Gjyqtari  
Berkan Hamza

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit, përmes kësaj Gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.